

VENDIM
Nr. 635, datë 7.9.2016

PËR LEJIMIN E LËVIZJES JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË SË VEPRËS SË ARTIT NË PIKTURË “KRIJIM I KOOPERATIVËS NË MALËSI”, E AUTORIT ZEF SHOSHI, PJESË E FONDIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE, E CILA DO TË MARRË PJESË NË EKSPOZITËN “SHQIPËRIA, 1207 km NË LINDJE”, QË ORGANIZOHET NË MUZEUN E QYTETËRIMEVE TË EVROPËS DHE MESDHEUT (MUCEM), NË MARSEJË, FRANCË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë së veprës së artit në pikturë “Krijim i kooperativës në Malësi”, e autorit Zef Shoshi, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, e cila do të marrë pjesë në ekspozitën “Shqipëria, 1207 km në Lindje”, që organizohet në Muzeun e Qytetërimeve të Evropës dhe Mesdheut (MUCEM), në Marsejë, Francë, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 9 shtator 2016–1 shkurt 2017.

3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohen Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

5. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA

Nr.	Imazhi	Nr. i inv.	Titulli	Autori	Teknika	Përmasa	Viti	Çmimi, lekë
1.		1604	Krijimi i kooperativës në malësi	Zef Shoshi	Vaj	184 x 220.5 cm	1974	200,000